



J REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.03, datë 28.12.2022


PËR
KONFISKIMIN PËR INTERES PUBLIK TË SIPËRFAQES SË NDËRTUAR NË
TEJKALIM TË LEJES SË NDËRTIMIT:
“RIKONSTRUKSION ME SHTIM VOLUMI I HOTELIT EKZISTUES 3 KAT DHE
SHTESË 2 KAT HOTEL”, ME VENDNDODHJE LAGJJA Nr. 13, PLAZH,
NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, me propozim të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Konfiskimin për interes publik të sipërfaqes së ndërtuar për qëllim fitimi, në tejkalim të Lejes së Ndërtimit të Kryetarit të Bashkisë Durrës, Nr. 712, datë 01.10.2018 “Rikonstruksion me shtim volumi i hotelit ekzistues 3 Kat dhe shtesë 2 kat hotel”, me vendndodhje Lagjja 13, Plazh, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, me zhvillues Z. Dritan Xhura, pasi kjo sipërfaqe (290 m²), tejkalon masën mbi 10 % të sipërfaqes ndërtimit mbi tokë, sipas Lejes së sipërcituar.
2. Planvendosja e objektit të konfiskuar, bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit të përcjellë këtë vendim pranë Ministrisë përgjegjëse në varësi të të cilës gjendet autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të konfiskuara të shtetit.
4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ose autoriteti përfitues i konfiskimit të aplikojë nëpërmjet sistemit e-leje, për miratimin e një Leje Zhvillimi/Ndërtimi të re, si dhe lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit, me qëllim rregullimin e pasojave të shkaktuara nga situata faktike, e krijuar nga ndërtimi në tejkalim të lejes së ndërtimit.

5. Pas miratimit të lejes përkatëse, Bashkia Durrës të lëshojë certifikatën e përdorimit, në përputhje me këtë vendim dhe planvendosjen bashkëlidhur.
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të kryejë regjistrimin e këtij vendimi, së bashku me certifikatën e përdorimit, sipas parashikimeve në VKM-në Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”.
7. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I BRENDSHËM
BLEDAR ÇUÇI



ANËTAR

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT

